



RTK 1
Mentor Shala
Drejtor
Prishtinë

Rasti Nr. 2018/189
Ref:1812/1398/KPM/mf

VENDIM

Lidhur me Ankesën e z. Gani Geci (Palë Ankuese) kundër RTK 1 (Palë Përgjegjëse)

Faktet

1. Komisioni i Pavarur i Mediave (KPM) ka miratuar Kodin e Etikës për Ofruesit e Shërbimeve Mediale në Republikën e Kosovë KKPM-2016/03, i cili ka hyrë në fuqi më 11 tetor 2016. Me Kodin e Etikës KKPM-2016/03 janë përcaktuar rregullat e sjelljes dhe të punës së shërbimeve mediale audiovizuale në pajtim me dispozitat ligjore që janë të domosdoshme në një shoqëri demokratike.
2. KPM me datën 14 tetor 2018 ka pranuar një ankesë nga Pala Ankuese ndaj kronikës "Për thirrjet për etikë në media që vijnë nga Kosova", të transmetuar me datën 27 tetor 2018 në edicionin e lajmeve të orës 19:30 në RTK 1. Pala Ankuese pretendon se Pala Përgjegjëse përmes kësaj kronike "ka shkelur politikat redaktuese të saja për shkak se lajmi i publikuar nuk ka përmbajtje informuese, përveç se me qëllime tendencioze për cenimin dhe denigrimin e personalitetit të z. Geci".
3. KPM me datën 15 nëntor 2018 përmes një shkrese e ka njoftuar Palën Përgjegjëse për ankesën e pranuar nga Pala Ankuese dhe ka kërkuar sqarim brenda tre (3) ditësh lidhur me pretendimet e ankesës.
4. KPM me datë 20 nëntor 2018 ka pranuar përgjigje nga Pala Përgjegjëse duke pretenduar se kanë vepruar sipas standardeve profesionale të gazetarisë si dhe konform rregullativës ligjore gjatë transmetimit të kësaj kronike.
5. KPM ka analizuar ankesën e Palës Ankuese si dhe ka monitoruar kronikën e lartpërmendur dhe në bazë të Raportit të monitorimit të datës 20 nëntor 2018 ka gjetur se Pala Përgjegjëse ka vepruar në kundërshtim me Kodin e Etikës KKPM-2016/03.

6. KPM, pas të gjeturave nga Raporti i monitorimit, me datën 26 nëntor 2018 i ka dërguar Palës Përgjegjëse Njoftim për Shkelje me të cilin e ka njoftuar për shkeljet e bëra dhe i ka kërkuar të veprojë në pajtim me Kodin e Etikës KKPM-2016/03.

Analiza Ligjore

7. Komisioni bazuar në të gjitha faktet dhe analizat e lartpërmendura konstaton se Pala Përgjegjëse ka bërë shkelje të nenit 7 Të drejtat individuale, paragrafi 1 dhe 5, të Kodit të Etikës KKPM-2016/03.

Neni 7, paragrafi 1, i Kodit të Etikës KKPM-2016/03 përcakton se:

“E drejta e privatësisë së individëve duhet të respektohet. Ndërhyrja në çështjet thjeshtë private apo personale të cilat nuk kanë ndikim në interesin publik është e ndaluar. Ata që janë prekur nga tragjedia apo pikëllimi duhet të trajtohen me ndjeshmëri, respekt dhe maturi duke e respektuar privatësinë e plotë të tyre.”

Komisioni në bazë të monitorimit të kronikës së transmetuar ka gjetur se Pala Përgjegjëse me datën 27 tetor 2018 në edicionin e lajmeve të orës 19:30 ka transmetuar të dhëna të ndjeshme, përkatësisht pjesë të raportit mjekësor të Institutit të Psikiatrisë Forenzike të siguruar nga gjykatat kosovare, rreth gjendjes psikiatrike shëndetësore të Palës Ankuese në kronikën *“Për thirrjet për etikë në media që vijnë nga Kosova”*.

Neni 7, paragrafi 5, i Kodit të Etikës KKPM-2016/03 përcakton se:

“Sulmet personale, duke përfshirë por duke mos u kufizuar vetëm në sulmet në ndershmërinë, integritetin apo cilësinë personale të një personi, institucioni apo grupi të identifikuar, në çështje që nuk kanë të bëjnë me interesin publik, janë të ndaluara.”

Komisioni në bazë të monitorimit të kronikës ka gjetur se Pala Përgjegjëse gjatë transmetimit të kronikës nuk ka ndërmarrë asnjë veprim për ta mbrojtur dinjitetin e Palës Ankuese, duke transmetuar të dhëna të cilat lidhen me cilësitë personale të Palës Ankuese, veprim ky i cili bie në kundërshtim me nenin 7, paragrafi 5, të Kodit të Etikës KKPM-2016/03.

8. Komisioni bazuar në të gjeturat e monitorimit, analizimin e ankesës së Palës Ankuese dhe përgjigjen e Palës Përgjegjëse, ka gjetur se Pala Përgjegjëse ka bërë shkelje të Kodit të Etikës KPM-2016/03, gjatë transmetimit të kronikës *“Për thirrjet për etikë në media që vijnë nga Kosova”*.
9. Komisioni, duke u bazuar në faktet e lartpërmendura ka gjetur se Pala Përgjegjëse ka bërë shkelje të nenit 7, paragrafi 1 dhe 5, të Kodit të Etikës KKPM-2016/03.

